



KOMUNIKATË

Propozim-Rregullorja mbi Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikimin Hapësinor vihet në dispozicion të publikut prej fillimit

Bazuar në dispozitat e ligjeve në fuqi si dhe në orientimin strategjik të Komunës së Prizrenit, Kuvendi Komunal në partneritet me OJQ EC Ma Ndryshe ka iniciuar procesin për hartimin e Rregullores mbi Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit, i cili më pastaj do të miratohet dhe zbatohet nga organet përkatëse komunale. Të hënën, më 5 tetor 2015, është mbajtur takimi i radhës i Komisionit për hartimin e kësaj rregulloreje.

Pas takimeve të para të grupit punues, të përbërë nga anëtarë të Kuvendit të Komunës, zyrtarë të Ekzekutivit lokal, aktivistë nga EC Ma Ndryshe e KDI dhe profesionistë nga UN Habitati, është përpiluar drafti i parë i rregullores, i cili është i hapur edhe për komentet nga publiku, në mënyrë që më pastaj të përcillet te organet komunale për procedim të mëtutjeshëm sipas dispozitave ligjore.

Lidhur me draftin e parë të rregullores, të interesuarit mund të ofrojnë sugjerimet, vërejtjet dhe propozimet deri më 12 tetor 2015. Të gjitha komentet në lidhje me këtë propozim-akt do të prezantohen para komisionit të përbashkët për hartimin e rregullores dhe pas harmonizimit i njëjti do të procedohet te organet komunale për të hyrë në agjendën e punës së KK-së së Prizrenit.

“Inicimi i procesit për hartimin e Rregullores mbi Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit, bashkë me shoqërinë civile dhe me akterë të tjerë është një hap në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, që është edhe njëri prej synimeve kryesore të propozim-rregullores që është në përpilim e sipër”, thotë kryesuesi i KK-së, Kujtim Gashi.

“Pjesëmarrja si proces, përfshinë apo pasqyron në vete një numër të drejtave themelore të qytetarëve, si ajo për t’u informuar, për t’u dëgjuar dhe për të ndikuar në aktivitetet që lidhen me kushtet dhe ambientin jetësor të tyre. Prandaj përpilimi dhe miratimi i kësaj rregulloreje është i rëndësishëm për qytetarët e Komunës së Prizrenit dhe ata mund të ofrojnë kontributin në përpilimin e saj”, thekson drejtori ekzekutiv i OJQ EC Ma Ndryshe, Hajrulla Çeku.

Draftin e parë të Rregullores mbi Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor në Komunën e Prizrenit mund ta gjeni dhe ta shkarkoni në këtë link: <http://www.online-transparency.org/rpms/?page=1,23,150&c=1#.VhJeuX2GNB5> (te butoni Shkarko), dhe në pjesën e mëposhtme të faqes mund ti dërgoni komentet tuaja.

Me respekt,
Kujtim Gashi, kryesues
Kuvendi Komunal Prizren

Hajrulla Çeku, drejtor ekzekutiv
OJQ EC Ma Ndryshe